



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. prot _____

Tiranë __/__/2018

NJOFTIM

Bazuar në ligjin Nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 53, njoftoj thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak për të shqyrtuar p/vendimet e paraqitura nga Bashkia e Tiranës, ditën e enjte, datë 26.07.2018, ora 11:00, në sallën e Këshillit Bashkiak, me këtë rend dite:

1. P/Vendim “Për propozim për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 1-31.7.2018”.
2. P/Vendim “Për miratimin e pagesës për PAK dhe Invalidët e Punës, për periudhën 1- 31 Korrik 2018”.
3. P/Vendim “Për miratimin e familjeve aplikuese që përfitojnë nga programi i bllok- ndihmës ekonomike deri në 6 përqind, nga fondi i kushtëzuar dhe nga buxheti i Bashkisë Tiranë, për periudhën 1- 30 Qershor 2018”.
4. P/Vendim “Për miratimin e kompensimit të çmimit të energjisë elektrike për kategorinë përfituese, për periudhën 1- 30 Qershor 2018”.
5. P/Vendim “Për dhënien e emrit “Drita Pelinku” të shkollës 9- vjeçare “Sabaudin Gabrani” me adresë rruga “Muhamet Gjollesha”, Njësia Administrative nr.7, Tiranë”.
6. P/Vendim “Për dhënien e emrit “Marie Logoreci” të shkollës 9- vjeçare “Androkli Kostallari” me adresë rruga “Ali Shefqeti”, Njësia Administrative nr.1, Tiranë”.
7. P/Vendim “Për miratimin dhe zbatimin e udhëzuesit operacional mbi përfitimin e bonusit të strehimit në Bashkinë Tiranë”.
8. P/Vendim “Për zbatimin e projektit “Programi i Nxitjes së Punësimit të Biznesit Rinor II”, hartuar sipas Udhëzuesit Operacional për zbatimin e këtij Projekti”.

9. P/Vendim “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Tiranë dhe Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, përcaktimi i mënyrave të bashkëpunimit mes palëve për realizimin efektiv të projektit “Hapja e tregut publik të rrobave të përdorura për nxitjen e vetëpunësimit dhe tregtinë ambulatore të komunitetit Rom dhe Egjiptian, në adresën rruga “Ali Shefqeti”, Njësia Administrative Nr.1, Tiranë”.
10. P/Vendim “Për disa ndryshime në vendimin nr.81, datë 26.07.2017 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin në parim të studimit të fizibilitetit dhe të kontratës “Tip” të partneritetit publik privat “Për përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë Tiranë”, ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe partnerit privat”.
11. P/Vendim “Për miratimin në parim të dhënies me qira të objektit “Reparti i Pastrimit të Fonderisë së Gizës, me sipërfaqe totale prej 1592.8 m2, ku 1241.6 m2 sipërfaqe nën objekt dhe 351.2 m2 sipërfaqe funksionale, pasuri në administrim të UPNA”.
12. P/Vendim “Për dhënie në përdorim Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), të një sipërfaqeje prej 372 m2 e regjistruar me numër pasurie 7/521 në zonën kadastrale 8230, Tiranë”.
13. P/Vendim “Për miratimin në parim të dhënies me qira të pasurisë së llojit “truall”, me sipërfaqe 10 458.81 (dhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë, pikë tetëdhjetë e një) m2 në rrugën “Hamdi Pepa”, në pronësi të Bashkisë Tiranë”.
14. P/Vendim “Për miratimin në parim të dhënies me qira të repartit të orëve, Ndërmarrja Metalike Tiranë”.
15. P/Vendim “Për krijimin e kopshtit dhe çerdhes së integruar në Njësine Administrative Nr.4”.
16. P/Vendim “Për zgjatjen me një muaj të kontratës së punonjësve sezonalë të Drejtorisë Nr.3 të Punëtorëve”.
17. P/Vendim “Për miratimin e ndryshimit të kontratës tip dhe aktmarrëveshjes për banesat sociale Shkozë”.

MBLEDHJET E KOMISIONEVE

- **Komisioni i Kulturës, Turizmit dhe Figurave të shquara të qytetit:**
Komisioni do të shqyrtojë pikat 5, 6 dhe do të mblidhet ditën e martë, datë **24.07.2018, ora 11:00.**
- **Komisioni për Politikat Rinore:**
Komisioni do të shqyrtojë pikën 8 dhe do të mblidhet ditën e martë, datë **24.07.2018, ora 12:00.**
- **Komisioni i Strehimit dhe Çështjeve Sociale:**
Komisioni do të shqyrtojë pikën 7, 8 dhe do të mblidhet ditën e martë, datë **24.07.2018, ora 13:30.**
- **Komisioni i Financës, Ekonomisë dhe Nxitjes së Sipërmarrjes:**
Komisioni do të shqyrtojë pikën 1, 2, 3, 4, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe do të mblidhet ditën e mërkurë, datë **25.07.2018, ora 12:00.**
- **Komisioni Juridik:**
Komisioni do të shqyrtojë pikën 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe do të mblidhet ditën e mërkurë, datë **25.07.2018, ora 14:00.**

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI